

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"4R ECO Group" SH.P.K**

Sot, më datë 9 /03/2024 (dymijë e njëzetë e katër), të pranishëm:

- 1) **Renis Tërshana**, lindur në Tiranë, Shqipëri, i datëlindjes 23.09.1971, mbajtës i Letërnjoftimit nr. H109123040R, zotërues i 1 (një) kuotë, me vlerë 167 ALL, që përfaqëson 16,7 % të kapitalit;
- 2) **Ervis Myftari**, lindur në Tiranë, Shqipëri, i datëlindjes 08.05.1979, mbajtës i Letërnjoftimit nr. H90508052H, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë 167 ALL, që përfaqëson 16,7 % të kapitalit;
- 3) **Renaldo Zaimaj**, lindur në Frashër, Shqipëri, i datëlindjes 16.06.1985, mbajtës i Letërnjoftimit nr. I50616184G, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë 167 ALL, që përfaqëson 16,7 % të kapitalit;
- 4) **Rako Paja**, lindur në Çorrotat, Shqipëri, i datëlindjes 04.07.1982, mbajtës i Letërnjoftimit nr. I207040040, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë 167 ALL, që përfaqëson 16,7 % të kapitalit;
- 5) **Dritan Marku**, lindur në Karicë, Shqipëri, i datëlindjes 10.04.1978, mbajtës i Letërnjoftimit nr. H80410274J, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë 332 ALL, që përfaqëson 33,2 % të kapitalit;


në cilesinë e ortakëve themelues të shoqërisë, shpallin hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Themelimi në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me termat si më poshtë vijon:

**Neni 1
Emërtimi**

Themelohet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e emërtuar "**4R ECO Group**" sh.p.k. (në vijim e quajtur "Shoqëria")

Shoqëria është themeluar sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar, si dhe fiton personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me Aktin e Themelimit dhe me Statutin.



Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa 42, Hyrja nr. 7, Ap. 32, Tiranë.

Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, mund të hapë seli dytësore, filiale, zyra përfaqësimi, degë ose agjensi si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin e Shoqërive Tregtare deri sa të mbyllet me akte ligjore.

Neni 4

Objekti

Shoqëria ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

1. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e erës, termocentralet, biomasa etj.
2. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmëse. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qëndrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit.

Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mësipërm.

Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. Duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe çdo aktivitet aksesor i lidhur mesa më sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të tokës, punime civile, elektrike dhe mekanike të çdo lloji si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim

dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto çështje, gjithashtu dhe në fushën e aktiviteteve të tregtimit.

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë) dhe është i përbërë nga 5 (pesë) kuota.

Kapitali themeltar zotërohet totalisht nga ortakët themelues të saj. Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve shtrihet deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6 Administrimi

Shoqëria administrohet nga një osë disa Administratorë, që:

- a) Mund të mos jetë ortak;
- b) Do të ushtrojë detyrën për një periudhë që do të përcaktohet kohë pas kohe nga Asambleja e Ortakëve në Aktin e Emërimit, e cila në asnjë rast nuk mund të jetë më e gjatë se 5 (pesë) vite;

Përfundimisht, detyrën e parë të Administratorit do ta ushtrojë Ervis Myftari, lindur në Tiranë, Shqipëri më datë 08.05.1979, mbajtës i Letëmjofimit nr. H9050805H.

Neni 7 Viti ushtrimor

Viti ushtrimor i shoqërisë fillon më datë 1 Janar dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor të çdo viti.

Përfundimisht, viti i parë ushtrimor fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor 2024.

Neni 8 Prishja dhe likuidimi

Në rast prishje dhe likuidimi të Shoqërisë, për çfarëdo arsye dhe në çdo moment, Asambleja e Ortakëve do të emërojë likuidatorin ose likuidatorët në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9

Ligji i Zbatueshëm

Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do t'i bëhet shprehimisht referencë Akt Themelimit të Shoqërisë dhe legjislacionit shqiptar në fuqi në fushën e shoqërive tregtare, veçanërisht ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.


Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe ortakëve, apo midis vetë ortakëve, që nuk mund të zgjidhet në mirëkuptim midis tyre, do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 10 Të ndryshme


Ky Akt Themelimi i Shoqërisë është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë, dhe nënshkruar rregullisht nga ortakët.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "4R ECO GROUP" SH.P.K.


Renis TËRSHANA




Rako PAJA



Ervis MYFTARI



Renaldo ZAIMAJ



Dritan MARKU

